



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1296, date 11.06. 2010

Për
Miratimin e dokumentit “Rregullore per procedurat e zgjidhjeve te mosmarreshjeve”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 11.06.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “Rregullore per procedurat e zgjidhjeve te mosmarreshjeve”

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja n) dhe p) te neni 8, neni 110, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 dhe neni 120 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (KprA)

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N:

Dokumentacioni për **“Rregullore për procedurat e zgjidhjeve të mosmarreveshjeve”** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë parasysh rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti, si një akt nenligjor i rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, kur ato lidhen me zbatimin e ligjit nr.9918 ,date 19.05.2008, bazuar në pikën n) dhe p) të nenit 8, 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, nenit 120 të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Te miratojë **“Rregullore për procedurat e zgjidhjeve të mosmarreveshjeve”**, sipas dokumentit bashkelidhur.
2. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**